




TERMAT E REFERENCËS



Agjencia Kombëtare e Rinisë

Përmbajtja

I. Informacion i përgjithshëm mbi projektin	3
II. Objektivi i pozicionit.....	3
III. Përshkrimi i punës	3
IV. Rezultatet e pritshme.....	3
V. Kualifikimet dhe përvoja.....	4
VI. Kohëzgjatja dhe lloji i angazhimit	4
VII. Dokumentacioni i aplikimit	4
VIII. Procedura e përzgjedhjes.....	4
IX. Dispozita të përgjithshme.....	5

TERMA REFERENCE

Pozicioni: Financier

Projekti: GOVER-NET (Governance Opportunities in VET for Empowerment and Regional Innovation – Network for Education and Transnational Cooperation)

Kohëzgjatja e projektit: 24 muaj

I. Informacion i përgjithshëm mbi projektin

Projekti GOVER-NET synon forcimin e kapaciteteve të administratorëve lokalë, trajnerëve VET dhe organizatave jofitimprurëse në zonat rurale për zhvillimin e modeleve inovative të qeverisjes pjesëmarrëse, me fokus të veçantë përfshirjen e grupeve vulnerabël, përfshirë të rinjtë NEET, vajzat dhe gratë. Projekti zbatohet nga një konsorcium ndërkombëtar me koordinator TRELAB (Itali), ndërsa Agjencia Kombëtare e Rinisë merr pjesë si partner përfitues në zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara në Work Packages përkatëse.

II. Objektivi i pozicionit

Financieri do të jetë përgjegjës për monitorimin dhe verifikimin e shpenzimeve të realizuara nga Agjencia Kombëtare e Rinisë në kuadër të projektit GOVER-NET, me qëllim sigurimin e përputhshmërisë me rregullat financiare të programit Erasmus+, buxhetin e miratuar dhe kërkesat e raportimit ndaj partnerit koordinator.

III. Përshkrimi i punës

1. Kontrolli dhe verifikimi financiar

- Monitoron dhe verifikon dokumentacionin financiar të projektit.
- Kontrollon përputhshmërinë e shpenzimeve me buxhetin e miratuar dhe rregullat e programit Erasmus+.
- Verifikon dokumentacionin mbështetës, përfshirë kontrata, fatura, prova pagesash dhe dokumente të tjera financiare.

2. Raportimi financiar

- Bashkëpunon me Menaxherin e Projektit dhe strukturat financiare të AKR për përgatitjen e raporteve financiare.
- Siguron saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit financiar për raportim.
- Përgatit dokumentacionin financiar mbështetës sipas kërkesave të projektit.

3. Identifikimi i rreziqeve financiare

- Evidenton shpenzimet që mund të jenë jo të pranueshme.
- Jep rekomandime për përmirësimin e procedurave financiare.
- Mbështet përmirësimin e praktikave të menaxhimit financiar të projektit.

IV. Rezultatet e pritshme

- Verifikim korrekt dhe në kohë i shpenzimeve të projektit.
- Përputhshmëri e plotë me rregullat financiare të programit Erasmus+.
- Identifikim dhe adresim në kohë i rreziqeve financiare.
- Mbështetje efektive në procesin e raportimit financiar të projektit.

V. Kualifikimet dhe përvoja

Kandidati/ja duhet të plotësojë këto kriteret:

- Diplomë universitare në Financë, Kontabilitet, Ekonomi ose fusha të ngjashme.
- Minimumi 4 vite përvojë profesionale në kontroll financiar, auditim ose menaxhim financiar projektesh.
- Përvoja në projekte të financuara nga Bashkimi Evropian përbën avantazh.
- Njohuri të mira të rregullave të menaxhimit financiar dhe raportimit sipas programeve të BE-së.
- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Aftësi analitike dhe organizative shumë të mira.

VI. Kohëzgjatja dhe lloji i angazhimit

Angazhimi do të jetë për një periudhë që përkon me kohëzgjatjen e projektit (24 muaj), me intensitet pune sipas nevojave të planit të aktiviteteve.

Lloji i kontratës do të përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregullat e menaxhimit financiar të projektit.

VII. Dokumentacioni i aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë:

- CV të përditësuar;
- Letër motivimi që përshkruan përvojën dhe aftësitë e tyre relevante;
- Çdo dokument tjetër mbështetës që vërteton përvojën profesionale.

VIII. Procedura e përzgjedhjes

- **Faza 1:** Shqyrtimi i kualifikimeve dhe eksperiencës.
- **Faza 2:** Intervistë profesionale në shqip dhe anglisht.

AKR rezervon të drejtën të mos përzgjedhë asnjë kandidat nëse nuk plotësohen kriteret e kërkuara.

IX. Dispozita të përgjithshme

Angazhimi në këtë projekt do të realizohet në përputhje me rregullat e Programit Erasmus+, Grant Agreement dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

Të dhënat personale do të trajtohen në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

X. Afati për aplikime

Aplikimet duhet të dërgohen në adresën elektronike info@rinia.gov.al deri më datë 07.04.2026, ora 16:00.

Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR)

"Rruga Naim Frashëri" nr 37, Tiranë, Shqipëri

AKR është një punëdhënëse me mundësi të barabarta dhe inkurajon kandidatët me prejardhje të ndryshme të aplikojnë.

Shënim: Termat e mësipërme të referencës janë një udhëzues i përgjithshëm dhe mund të jenë subjekt i modifikimit sipas nevojave të AKR.